



Znj. Elona Sevrani, mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare prej muajit Janar 2017 dhe mbështetur në Ligj nr.17 /2018 për statistikën zyrtare është anëtare e Bordit Drejtues të Institutit të Statistikave (INSTAT).

Znj. Sevrani është diplomuar për Ekonomiks, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, në vitin 2000. Studimet pasuniversitare në Administrim Publik i ka përfunduar pranë të njëjtit Fakultet, në vitin 2011.

Në vitin 2000, Znj. Sevrani u bë pjesë e INSTAT, fillimisht si specialiste në sektorin e Llogarive kombëtare dhe për një periudhë rreth 11 vjecare, ka ushtruar funksione drejtuese, në Drejtorinë e Llogarive Kombëtare.

Gjatë karrierës së saj profesionale ka kryer një sërë kualifikimesh afatshkurtra e afatgjata në institucione ndërkombëtare, si EUROSTAT, FMN, OECD dhe Institute homologe të Statistikave në fushën e prodhimit statistikor, analizës së të dhënave si dhe në menaxhimin e cilësisë statistikore.

Falë eksperiencës shumë vjeçare, Znj. Sevrani zotëron aftësi profesionale në kryerjen analizave të thelluara ekonomike, statistikore, menaxhimin e projekteve dhe ndërveprimin me aktorë të tjerë institucionalë të fushës.

Prej vitit 2019 është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë Departamentit të Ekonomiksit, në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës.